

## Çka do të thonë shkurtesat?

**MRSA** (meticillinresistenta Staphylococcus aureus) është një stafilokok i cili është rezistent ndaj disa antibiotikëve, p. sh. ndaj penicilinës. Stafilokokët mund të gjenden në hundë, nëpër lëkurë dhe nëpër mukoza të shumica prej nesh. Nganjëherë këto bakterie shkaktojnë infeksione, p. sh. në varrë ose në lunga e çibanë (i thatë).

**VRE** (vancomycinresistenta enterokocker) është një enterokok i cili është rezistent ndaj disa antibiotikëve. Enterokoku është një bakterie e cila gjendet në zorrë.

**ESBL** (Extended Spectrum Beta Lactamase) është një enzimë e cila mund t`i krijojë disa bakterie të zorrëve (p. sh. kolibakterie). Bakteriet të cilat krijojnë ESBL-në janë rezistente ndaj disa antibiotikëve. Kolibakteriet normalisht ndodhen në zorrë bashkë me shumë bakterie të tjera.

**E përbashkët për formimin e bakterieve VRE dhe ESBL** është se njeriu më së shpeshti vetëm i bart ato në zorrë. Gjatë tërë kohës gjersa ato gjenden në zorrë, ato nuk vërehen. Ato nganjëherë mund të shkaktojnë infeksione, më së shpeshti shkaktohen infeksione në kanalet e urinës dhe plagë të infektuara.

Kultivimi bakterial për  
bakterie të fuqishme  
rezistente (rezistente  
ndaj atibitikëve) ty të  
bëhet për

MRSA, VRE, ESBL...

## **Cilëve pacientë u bëhet kultivimi baktetrial ndaj bakterieve të fuqishme rezistente = bakteriet rezistente?**

Në shumë vende është dukuri më e zakonshme me bakteriet rezistente se sa në Suedi. Pacientët të cilët në dhjetë vitet e fundit janë shëruar në spitale/ ambulanca jashtë vendit, për këtë arsye kontrollohen për bakteriet rezistente të cilat emërtohen MRSA, VRE dhe ESBL (shiko sqarimin në faqen e fundit).

Gjithashtu nganjëherë mund të jetë aktuale që të kontrollohen pacientët duke u bërë atyre kultivimin bakterial e të cilët janë shëruar në një repart njëkohësisht me ndonjë pacient tjetër i cili bart bakterie rezistente.

MRSA, VRE dhe ESBL nuk janë sëmundje, por janë emërtime për bakteriet të cilat janë bërë më shumë rezistente ndaj antibiotikëve, p. sh. ndaj penicinis.

Që ty të mund të jepet antibiotiku i duhur me rastin e një infeksioni është me rëndësi që të dihet se a bart ti bakterie rezistente.

## **Çfarë do të thotë për mua si pacient që të më bëhet kultivimi bakterial për MRSA, VRE dhe ESBL?**

Kur ti kontrollohesh duke ta bërë kultivimin bakterial për bakteriet rezistente, ti do të kurohesh në një dhomë të zakonshme gjersa të merret përgjigjja për kulturën bakteriale.

Përgjigjja për kultivimin bakterial shpeshherë vjen pas 3 – 5 ditësh. Nëse kultivimi bakterial nuk tregon shfaqje të bakterieve rezistente ti mund të shërohesh pa restriksione në repart.

Nëse ndonjë kultivim bakterial tregon ndonjë shfaqje të bakterieve rezistente, ti do të marrësh më shumë informacione prej mjekut tënd trajtues.

## **Si bëhet shmangia e përhapjes së bakterieve në shërbimin mjekësor?**

I tërë personeli i shërbimit mjekësor gjithmonë do të punojë sipas "Rutinave themelore higjienike". Kjo, përpos të tjerash, do të thotë që duart pastrohen nga infeksionet me alkool ndërmjet të gjithë pacientëve.

### **Ti a mund ta mendosh që**

- të jeshë i kujdesshëm me higjienën tënde, në mënyrë të veçantë pas vizitës në toalet dhe para ngrënies së ushqimit,
- të bisedosh me personelin para se të dalësh nga dhoma jote para se ta keshë marrë përgjigjjen për kultivimin bakterial,
- farefisi mund të vizitojë si zakonisht.

